

Emri i Maqedonisë: Zgjidhja e nyjes

I. PËRMBLEDHJE

Maqedonia është një storie relativisht e suksesshme në një rajon të goditur nga çështje të pazgjidhura të shtetësisë dhe teritoreve. Që nga konflikti i vitit 2001 me kryengritësit etnikë shqiptarë, angazhimi ndërkombëtar ka kontribuar drejt progresit të integritit të shqiptarëve në jetën politike. Kjo është mbështetur nga premtimi për integrim në Bashkimin Evropian (BE) dhe NATO, synime këto që bashkojnë maqedonasit etnikë dhe shqiptarët. Mirëpo, strategjia kryesore e NATO-s/BE-së për stabilizimin e Maqedonisë dhe të rajonit nëpërmjet anëtarësimit, ka pësuar ngecje në 2008, për arsye të mosmarrëveshjes mbi emrin me Greqinë. Athina pohon se, duke e quajtur veten “Maqedoni”, kjo e fundit përveç të trashëgimisë helene, si dhe ka interes në pjesën veriore të Greqisë. Në samit kjo e fundit ka bllokuar anëtarësimin e Maqedonisë në NATO si dhe bisedimet për anëtarësim në BE, deri atëherë kur të zgjidhet kjo çështje. Edhe pse mund të jetë mistike për të huajt, mosmarrëveshja prek thellë dhe ndjeshëm ezistencën, sidomos në Maqedoni, si dhe ka implikime serioze në rajon. Palët kanë nevojë që përsëri të kthejnë besimin, ndërsa shtetet anëtare duhet t’u bëjnë presion ayre që të bëjnë kompromis, sidomos që Greqia të respektojë përkushtimin e saj për të mos bllokuar anëtarësimin e Shkupit në organizatat ndërkombëtare.

Përpjekjet për të tejkaluar mosmarrëveshjen me anë të negociatave nën mbikëqyrjen e OKB-së nuk kanë treguar rezultate për më shumë se një dekadë. Në dhjetor 2001, Grupi i Krizave kishte thënë se zgjidhja e kësaj çështjeje ishte vitale për të përforcuar sensin e brishtë të identitetit të maqedonasve, gjë që sfidohet nga tre fqinjë: Greqia, e cila kundërshton emrin e vendit; Bullgaria e cila ka vënë në pikëpyetje ekzistencën e kombit apo gjuhës maqedonase; dhe Serbia, e cila e kundërshton autonominë e kishës së saj. Sensi i identitetit të maqedonasve është sfiduar edhe më tej nga koncesionet e domosdoshme që ata i kanë bërë bashkësitetasve të tyre, sipas Marrëveshjes së Ohrit, me të cilën përfundoi konflikti i vitit 2001. Këto kërkojnë që ta kthejnë vendin në një shtet “qytetar”, duke ngritur të drejtat e pakicave shqiptare dhe të tjera, mirëpo njëkohësisht ato zbusin esencën e saj si mëmëdheu i popullit maqedonas.

Më 2001, Grupi i Krizave sugjeroi një kompromis, sipas të cilit emri “Republika Makedonija” në gjuhën maqedonase, do të shfrytëzohej nga OKB-ja dhe të gjitha organizatat e tjera ndërkombëtare, dhe do të njihej nga shtetet anëtare të NATO-s dhe BE-së dhe të tjerët. Sot Greqia e ka forcuar kundërshtimin e saj në NATO dhe në BE. Maqedonisë i ishte dhënë statusi i kandidatit të BE-së më 2005, por jo edhe data për fillimin e negociatave për anëtarësim. Deri më 2008, ajo i kishte përbushur kriteret për anëtarësim në NATO, mirëpo asaj nuk i’u dha ftesa për anëtarësim. Përveç kërcënimit të Greqisë rreth çështjes së emrit, hapja e bisedimeve për anëtarësim të vendit në BE, po vonohet edhe për arsye të dështimit të saj për të arritur standardet e përcaktuara nga Komisioni Evropian. Për ilustrim, disa mungesa serioze që u panë gjatë zgjedhjeve të qershorit 2008, do të duhet të adresohen në zgjedhjet e vitit 2009.

Përkundër progresit të konsiderueshëm, Marrëveshja e Ohrit nuk është implementuar në tërësi. Tensionet ndër-etnike dhe rreziku i destabilitetit mbesin akoma. Ambienti rajonal është i brishtë, ndërsa potenciali nga Kosova për të pasur ndikim destabilizues në Maqedoni, ashtu siç ka qenë më 2001, vazhdon. Një vonesë e papërcaktuar drejt integritit në NATO dhe BE do të mund të dëmtonte atë që është arritur deri më tani drejt stabilizimit të vendit, me pasoja që do të ishin veçanërisht të dëmshme edhe ndaj vetë Greqisë. Mosmarrëveshja mbi emrin është më shumë sesa çështje bilaterale në mes të Shkupit dhe Athinës. Ajo rrezikon që të ndryshojë strategjinë kryesore të NATO-s dhe të BE-së për stabilizimin e Maqedonisë dhe të rajonit nëpërmjet anëtarësimit dhe integritit. Shtetet anëtare nuk duhet të lejojnë që kredibiliteti i këtyre organizatave të bie viktimë e një mosmarrëveshjeje kryeneçe në mes të Shkupit dhe Athinës, në të cilën përfshihet një nga anëtarët e tyre.

Në samitin e NATO-s, në prill 2008, në Bukuresht, Shkupi sinjalizoi gatishmërinë e vet për kompromis rreth emrit të vendit. Megjithatë, një kombinim i lëvizjeve nga të dyja anët ka prishur ambientin në të cilin mund të zhvillohen bisedimet deri në atë masë sa që të dy vendet tani janë më larg njëra tjetrës se kurdoherë tjetër që nga fillimi i viteve 1990-ta. Vendimi i Maqedonisë më 2007 për të riuaruar aeroportin e Shkupit sipas Aleksandrit të Madh u duk si një kalku-

lim për të provokuar ndjenjat greke mbi trashëgiminë helene. Duke bllokuar integrimin e Maqedonisë në NATO dhe BE, Greqia u duk se kundërshtoi përkohshëm të saj ndaj Marrëveshjes së Përkohshme të vitit 1995, për të mos lejuar që çështja e emrit të pengojë anëtarësimin e vendit në organizatat ndërkombëtare. Fakti që anëtarët e tjerë të NATO-s dhe BE-së lejuan që një gjë e tillë të ndodhë, ka dëmtuar besimin e Maqedonisë në vullnetin e mirë ndërkombëtar.

Në mënyrë që të rindërtohet besimi dhe që përfundimisht të zgjidhet mosmarrëveshja rreth emrit, duhet të ndërmerren këta hapa:

- Shkupi duhet të kthejë mbrapa vendimin e tij për emërimin e aeroportit të vet sipas Aleksandrit të Madh, dhe të ndalojë marrjen e hapave që me siguri e provokojnë Athinën;
- Shkupi dhe Athina duhet që së bashku të rishikojnë historinë e përbashkët të rajonit, me qëllim të shmangies së referencave të cilat ofendojnë ndjenjat kombëtare të njëra tjetrës, në literaturat e tyre shkollore;
- të dyja palët duhet të riafirmojnë përkushtimin e tyre ndaj Marrëveshjes së Përkohshme, dhe në pritje të një marrëveshjeje mbi emrin, Shkupi duhet të përdorë vetëm formën e përkohshme – “ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë” – në të gjitha organizatat multilaterale, ndërsa Athina duhet të heqë dorë nga kërcënimet e saj për përdorimin e vetos në NATO dhe BE;
- Shkupi duhet që publikisht të deklarojë se është i gatshëm të pranojë propozimin e fundit të ndërmjetësuesit të OKB-së që “Republika e Maqedonisë Veriore” të jetë emri për të gjitha qëllimet ndërkombëtare;
- Athina duhet të përgjigjet duke njohur identitetin dhe gjuhën kombëtare të fqiu të saj verior si “maqedonase” dhe duke pranuar sigurimin e Shkupit që përdorimi i atij mbiemri nuk do të thotë se ajo ka ndonjë ekskluzivitet apo interes territorial ndaj provincës veriore greke të Maqedonisë; dhe
- shtetet e tjera anëtare të NATO-s dhe BE-së duhet që aktivisht të inkurajojnë Athinën që ajo të zhbllokojë integrimin e Maqedonisë në të dy organizatat, dhe t’i përgjigjet pozitivisht koncesioneve të Shkupit mbi emrin e vendit.

II. ÇËSHTJA

Mosmarrëveshja e Maqedonisë me Greqinë rreth emrit ka vazhduar gjatë shtatëmbëdhjetë viteve që nga pavarësimi i saj.¹ Njohja e saj nga shtetet anëtare të BE-së u ngadalësua në janar 1992, kur u njoh pavarësia e Sllovenisë dhe Kroacisë, për shkak të kundërshtimeve të Athinës se ky vend kishte përvetësuar emrin dhe simbolet që ajo i konsideronte si ekskluzivisht helene, si dhe pohimeve të saj se Shkupi mbante ambicie irredentiste ndaj Greqisë veriore.² Si zgjidhje të përkohshme, në prill 1993 Maqedonia u pranua në OKB me emrin e saj të përkohshëm, “ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë.”³ Për shumicën e të huajve është e çuditshme, por kjo mosmarrëveshje iu ka rezistuar të gjitha përpjekjeve për t’u zgjidhur që atëherë.

A. ORIGJINA E MOSMARRËVESHJES

Ekzistojnë disa aspekte të kësaj mosmarrëveshjeje. Origjinat e saj gjenden në perspektivat e ndryshme nga të cilat të dy kombet i perceptojnë identitetet e tyre respektive. Çështja e historisë shkon mbrapa në erën e Aleksandrit të Madh, shekuj para ardhjes së sllavëve në Ballkan. Përdorimi nga Maqedonia i simboleve nga periudha klasike, që e identifikon shtetin modern me Aleksandrin, në përgjithësi vështrohet nga grekët si përvetësim ofendues i trashëgimisë helenike. Përvetësimi në fillim nga Maqedonia i flamurit ku paraqiteshin motive të “Yllit të Verginës” së Maqedonisë antike, e pat nevikosur në veçanti Greqinë.

Mosmarrëveshja mbi identitetin modern maqedonas është për nga origjina e kohëve të fundit. Në Luftërat Ballkanike të viteve 1912-1913, Maqedonia ishte e ndarë në mes të Greqisë, Bullgarisë dhe Serbisë. Pjesa që i shkoi Serbisë, e pastaj Jugosllavisë, përbënte, pak a shumë, territorin e republikës moderne. Grekët, bullgarët dhe serbët ishin të bashkuar në mohimin e ekzis-

¹ Shih Raportin e Grupit të Krizave për Evropë Nr. 122, *Emri i Maqedonisë: Pse Është e Rëndësishme Mosmarrëveshja dhe si ta Zgjidhim atë*, 10 dhjetor 2001, i cili shpjegon historien e gjerë rreth origjinën dhe historinë e mosmarrëveshjes lidhur me emrin.

² Kjo ishte kështu përkundër konkludimit të trupit këshillëdhënës të BE-së mbi çështjet ligjore që vinin në pah pas shkatërrimit të Jugosllavisë, Komisioni për Arbitrim nën Robert Badinter, sipas të cilit Maqedonia, pasi të ketë deklaruar se mohon të ketë pretendime territoriale, do të plotësonte kushtet për njohje. “Opinion Nr. 6 mbi njohjen e Maqedonisë”, Komisioni i Arbitrimit për Konferencën e Paqes mbi ish-Jugosllavinë, 11 janar 1992.

³ Nganjëherë me shkurtesat “FYROM”, një dizajn ky që në përgjithësi konsiderohet ofendues në Maqedoni.

tencës së një kombi të veçantë maqedonas. Në këto tri vende, politikat e edukimit, gjuhës dhe mbiemrat u munduan që të zhdoknin çfarëdo sensi të një populli të veçantë maqedonas. Pas vitit 1945, në Jugosllavinë komuniste, kjo politikë u kthye mbrapsht. Krijimi i një republike të veçantë maqedonase brenda Jugosllavisë e përforcoi sensin e identitetit të veçantë maqedonas kundruall sfidave bullgare dhe greke.

Në përgjithësi serbët e pranuan ekzistencën e kombit maqedonas, në vend se t'i vështronin thjesht si serbë të jugut, edhe pse mohimi nga ana e Kishës Ortodokse Serbe e ekzistencës së veçantë të Kishës Autoqefale Maqedonase vazhdon t'i tendosë nganjëherë marrëdhëniet e tyre. Pas pavarësisë së Maqedonisë, Bullgaria e njohu shtetin, por jo edhe popullin apo gjuhën e veçantë maqedonase.⁴ Si rezultat, maqedonasit vazhdojnë të ndihen të kërcënuar nga dështimi i të tre fqinjve për ta njohur plotësisht ekzistencën e tyre si komb.

Çelësi i ndjeshmërisë greke mbi identitetin maqedonas I takon periudhës së Luftës Civile Greke të 1940-ta. Gjatë atij konflikti, "Maqedonasit sllavë" në pjesën veriore të vendit përbënin një pjesë të theksuar të partizanëve të udhëhequr nga komunistët. Në përputhje me politikën që Tito e kishte trashëguar nga Comintern-i gjatë periudhës së luftërave, ata luftuan për të bashkuar pjesët jugosllave, greke dhe bullgare të Maqedonisë në një Maqedoni autonome, komuniste, brendapërbrenda Jugosllavisë. Pas mposhtjes së komunistëve në Greqi, dhjetëra mijëra partizanë u arratisën, duke përfshirë edhe shumë sllavë të cilët u vendosën në Maqedoninë jugosllave. Pronat e tyre në Greqi u konfiskuan dhe, përderisa refugjatët komunistë etnikë grekë u lejuan që të ktheheshin, maqedonasit sllavë nuk u lejuan. Për grekët, nocioni i një kombi të veçantë maqedonas kishte qenë një krijim artificial i Titos, me qëllim të rritjes së pretendimeve irredentiste kundër Greqisë, ndërsa gjuha maqedonase vetëm një dialekt lokal i bullgarishtes. Sipas kësaj pikëpamjeje, maqedonasit e vetëm të vërtetë janë grekët.⁵

Për maqedonasit, zgjidhja e emrit të tyre është më shumë sesa vetëm një e drejtë bazike e njeriut. Ajo ka të bëjë me vetë ekzistencën e tyre si popull. Ashtu si kurse mitologjia kombëtare greke e thekson vazhdimësinë ndërmjet botës antike helene, përfshirë këtu

edhe Maqedoninë antik, dhe asaj të shtetit modern grek, maqedonasit e shohin identitetin e tyre si të lidhur shumë afër dhe pandashëm me emrin e tyre. Ndryshimi qëndron në atë se, përderisa trashëgimia maqedonase është vetëm një pjesë e identitetit grek, për maqedonasit nuk ka identitet tjetër. Siç theksojnë nganjëherë maqedonasit, emri "Maqedoni" është në këngët e tyre. Nëse ata nuk janë maqedonas, atëherë çka janë ata? A janë ata sllavë amorfë apo, duke pasur parasysh ngjashmërinë linguistike, ndoshta bullgarë?

Shpesh të huajt e vështrojnë me padurim këtë mosmarrëveshje për emrin, duke pyetur se si është e mundur që një çështje në dukje kaq triviale, mund të marrë proporcione kaq të mëdha. Por përpjekjet për zgjidhje duhet të fillojnë nga kuptimi se identiteti kombëtar nuk është çështje triviale kur perceptohet se është në sulm, si për grekët ashtu edhe për maqedonasit. Për maqedonasit, vërja në pikëpyetje e identitetit të tyre është e lidhur me mbijetesën e vendit të tyre. Ata frikësohen se, në esencë, shumë grekë dhe të tjerë në rajon janë duke e sfiduar qëndrueshmërinë afat-gjatë të shtetit të tyre, së bashku me tensionet e saj të brendshme ndërmjet maqedonasve dhe shqiptarëve etnikë.⁶

B. MARRËVESHJA E PËRKOHSHME

Pas pranimit të Maqedonisë në OKB me emrin e saj të përkohshëm, në shkurt 1994, Greqia e thelloi mosmarrëveshjen, kur vendosi embargo ndaj fqiu të saj verior, ndaj gjitha mallrave përveç ushqimeve dhe barnave. Kjo në përgjithësi vetëm sa kontribuoi në rritjen e simpatisë ndërkombëtare për Maqedoninë. Një lloj akomodimi u arrit në shtator 1995, në prag të negociatave të Dejtonit, që përfundoi luftën në Bosnjë. I dërguari i posaçëm i OKB-së Cyrus Vance (ish-Sekretar i Shtetit Amerikan), me përfshirjen e Ndihmës Sekretarit Amerikan Richard Holbrooke, ndërmjetësuan një marrëveshje, Marrëveshjen e Përkohshme, sipas së cilës Greqia do të tërhiqte embargon dhe do të njihte Shkupin me emrin e saj të përkohshëm. Në anën tjetër, Shkupi pranoi që ta ndryshonte flamurin e vet, dhe ripohoi se asgjë në kushtetutën e saj nuk do të mund të konsiderohej si pretendim irredentist ndaj territorit grek.⁷

⁴ Deklarata e përbashkët e 22 shkurtit 1999, e nënshkruar nga kryeministrat bullgar dhe maqedonas, njeh ekzistencën zyrtare të gjuhëve bullgare dhe maqedonase. Ky tekst u riafirmua në një memorandum të përbashkët, të nënshkruar në janar 2008.

⁵ Për një diskutim të shkurtër mbi prapavijën historike të diferencave rreth identitetit maqedonas, shih Takis Michas, "Balkan Neighbors" ["Fqinjët ballkanikë"], në *The Wall Street Journal*, 29 prill 2008.

⁶ Bashkëbiseduesit maqedonas i thanë Grupit të Krizave se akademikët dhe komentatorët gazetaresk grekë, si dhe zyrtarët, shpesh e vënë në pikëpyetje ardhmërinë afatgjatë të Maqedonisë si shtet multi-etnik, aq i ndryshëm nga koncepti grek për shtet një-kombësh, që nuk i jep njohje pakicave etnike. Intervista të Grupit të Krizave, Shkup, tetor 2008.

⁷ "Interim Accord between the Hellenic Republic and the former Yugoslav Republic of Macedonia", ["Marrëveshja e Përkohshme në mes të Greqisë dhe ish-Republikës Jugosllave"], 1995.

Çka është kyçe, Greqia pranoi në Marrëveshjen e Përkohshme se nuk do të bllokonte anëtarësimin e Maqedonisë në organizatat ndërkombëtare në të cilat ajo bënte pjesë, përderisa në ato organizata Maqedonisë i referohej si “ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë”.⁸ Marrëveshja bënte thirrje për negociata mbi çështjen e emrit, nën mbikëqyrjen e OKB-së.⁹ Palët po ashtu u pajtuan që, në rast se njëra palë beson se simbolet që përbëjnë pjesë të trashëgimisë së tyre historike apo kulturore përdoren nga ana tjetër, atëherë pala përgjegjëse do të marrë masa të duhura korrigjuese, apo të shpjegojë se pse nuk e sheh të arsyeshme që të bëjë një gjë të tillë.¹⁰

C. MARRËVESHJA E OHRIT

Progresi i arritur me Marrëveshjen e Përkohshme erdhi në kontekstin e një momentumit më të gjerë ndërkombëtar për rregullimin e mosmarrëveshjeve të mbetura në Ballkanin Perëndimor në kohën e Dejtonit. Fatkeqësisht, vullneti ndërkombëtar për të adresuar çështjet që ende e dëmtojnë stabilitetin afat-gjatë të Maqedonisë, nuk ka qenë konsistente. Vetëm pas shtrirjes së konfliktit atje më 2001 në mes të maqedonasve etnikë dhe pakicës së madhe etnike shqiptare, pamë rikycjen serioze ndërkombëtare në skenë.¹¹ Marrëveshja e Ohrit, që pasoi, ishte njëfarë sukses. U arrit shmangia e një konfrontimi më të madh, dhe u vendosën bazat e një marrëveshjeje afatgjate me komunitetin etnik shqiptar, si dhe integrimi i tij i plotë në jetën politike. Që atëherë është arritur mjaft progres drejt implementimit të marrëveshjes. Komisioni Evropian, për shembull, kohëve të fundit citoi si arritje kyçe përfaqësimin më të barabartë të shqiptarëve në shërbimin civil, si dhe miratimin e ligjit për gjuhët.¹²

lave të Maqedonisë”, New York, 13 shtator 1995. Çështja e emrit u shmang në Marrëveshjen e Përkohshme, ku palëve iu referohej si “pala e pjesës së parë” dhe “pala e pjesës së dytë”.

⁸Po aty, Neni 11.

⁹Po aty, Neni 5.

¹⁰Po aty, Neni 7/3: “Nëse cilado palë beson se një apo më shumë simbole që përbëjnë pjesë të trashëgimisë së saj historike apo kulturore, është duke u shfrytëzuar nga pala tjetër, pala tjetër do të marrë masat e duhura dhe korrekte ose të tregojë se pse nuk mendon se është e nevojshme të marrë këtë hap”.

¹¹Sipas regjistrimit të popullsisë të 2002, shqiptarët etnikë përbëjnë rreth 25 përqind të popullatës dhe maqedonasit etnikë 64 përqind. Në mesin e pakicave më të vogla, janë 4 përqind turq, rreth 3 përqind romë, dhe afro 2 përqind serbë.

¹²“The former Yugoslav Republic of Macedonia, 2008 Progress Report”, [“Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Raporti i Progresit 2008”], Bruksel, 5 nëntor 2008, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/press_corner/key-documents/reports

Mirëpo, paralel me Ohrit, nuk u adresua mosmarrëveshja e emrit me Greqinë. U la mbrapa, e trajtuar thjesht si çështje bilaterale, për t’u zgjidhur brenda kornizës së negociatave të udhëhequra nga OKB-ja. Kjo ishte gabim. Siç ka pohuar Grupi i Krizave në atë kohë,¹³ duke adresuar vetëm ankesat e komunitetit etnik shqiptar, pa masa korresponduese për të risiguruar shumicën etnike maqedonase dhe për të përkrahur identitetin e saj të brishtë dhe të kërcënuar, marrëveshja e Ohrit nuk ishte e kompletuar në një aspekt të rëndësishëm. Ajo i korrigjonte ankesat afatgjata dhe legjitime të pakicës shqiptare, në atë mënyrë që shumica maqedonase i perceptonte si të ishin në dëm të saj. Duke kthyer Maqedoninë në një “shtet qytetar”, edhe pse e domosdoshme, e shkrinte esecën e saj si mëmëdheu i popullit maqedonas. Nervozizmi në mesin e maqedonasve etnikë për këtë marrëveshje që është shikuar kryesisht si jo e drejtë, nuk është zhdukur. Pranimi i koncesioneve që u kërkuan nga ajo do të bëhej më i fortë nëse do të adresoheshin kërkesa legjitime për njohjen e identitetit të tyre.

Nuk ka rrezik të menjëhershëm për kthim në konfliktin e dhunshëm. Sidoqoftë, Marrëveshja e Ohrit nuk është implementuar plotësisht, ndërsa integrimi i shqiptarëve në jetën politike maqedonase mbetet i pa kompletuar. Vazhdojnë tendosjet në mes të dy grupeve etnike, për shembull rreth trajtimit të veteranëve shqiptarë të konfliktit, përfshirë këtu edhe amnestinë e tyre të përgjithshme. Partitë shqiptare kërkojnë barazi ligjore ndërmjet këtyre ish-luftëtarëve dhe pjesëmarrësve etnik maqedonas në konfliktin më 2001, përfshirë dhe pensionet shtetërore. Një faktor komplikimi shtesë është tretmani i të dyshuarve për krime të luftës. Në mars 2008, partitë shqiptare e konsideruan thyerje të ligjit mbi amnestinë rihapjen e rasteve kundër katër ish-luftëtarëve shqiptarë, të cilët Tribunali Ndërkombëtar për Krime Luftë në ish-Jugosllavi i kishte kthyer në Shkup.¹⁴ Ligji i ri për gjuhën nuk i adreson plotësisht kërkesat shqiptare, për shembull mbi përdorimin e gjuhës shqipe në strukturat komanduese në ushtri dhe polici.

Rreth çështjeve si gjuha dhe simbolet, si dhe rivendosja e disa kufijve komunalë në të mirën e shqiptarëve, Partia me e madhe shqiptare, Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), ka qenë jashtëzakonisht e durue-

_nov_2008/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia_progress_report_en.pdf. Për më shumë rreth “Raportit të Progresit” të Komisionit Evropian, shih pjesën III, më poshtë.

¹³Raporti i Grupit të Krizave, *Emri i Maqedonisë*.

¹⁴Shih *Balkan Insight*, Balkan Investigative Reporting Network (BIRN), 4 mars 2008, www.balkaninsight.com/en/main/news/8343/.

shme.¹⁵ Mirëpo, këto çështje mbesin acaruese ndërmjet saj dhe partnerit të madh, etnik maqedonas të saj në qeveri, Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partisë Demokratike për Bashkim Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) të Kryeministrit Nikolla Gruevski, si dhe ndërmjet saj dhe partive etnike shqiptare në opozitë.

Një faktor kyç që e përforcon Ohrin ishte premtimi për integrim në NATO dhe BE, qëllim ky kryesor kombëtar, mbrapa të cilit janë të bashkuar maqedonasit dhe shqiptarët. Zëvendës-presidentja e BDI-së, Teuta Arifi, deklaroi për Grupin e Krizave, “Integrimi në NATO dhe në BE e mbajnë vendin bashkë”; ato janë “drita në fund të tunelit”, pa të cilat Maqedonia nuk do të zhvillohej lehtësisht si demokraci. Zgjerimi i NATO-s në Ballkan, shtoi ajo, ka “një efekt të rëndësishëm stabilizimi”, ndërsa lënia e vendin jashtë do të ketë pasoja serioze destabilizuese.¹⁶

Nëse integrimi në NATO dhe BE vonohen pa-fundësisht rreth një çështjeje që nuk i preokupon shqiptarët etnikë, është e dyshimtë se sa gjatë do të vazhdojë durimi i tyre. Për momentin, liderët kryesorë shqiptarë janë duke shfaqur durim rreth çështjes së emrit.¹⁷ Njohja nga ana e Shkupit, në fillim të tetorit 2008, e pavarësisë së Kosovës, ka pasur një efekt jashtëzakonisht pozitiv në perceptimin e shqiptarëve për Maqedoninë si shteti i tyre.¹⁸ Megjithatë, një vonesë e gjatë drejt integrimit në NATO dhe BE, gjersa Shqipëria dhe vendet e tjera në rajon ecin përpara, do të vendoste në pah pakënaqësinë e tyre.

Konteksti më i gjerë rajonal vazhdon të jetë i parregulluar, ndërsa mbetet potenciali që Kosova të ketë

efekt destabilizues në Maqedoninë, ashtu si ishte rasti në konfliktin e vitit 2001.¹⁹ Do të ishte gabim nëse rrezikohet progresi i vërtetë për stabilitet në Maqedoni sipas Marrëveshjes së Ohrit, nëse lejohet që mosmarrëveshja mbi emrin të pengojë apo ngadalësojë integrimin e saj euro-atlantik. Kjo është më shumë sesa një mosmarrëveshje bilaterale në mes Shkupit dhe Athinës. Kjo rrezikon ndryshim të strategjisë kryesore të NATO-s dhe BE-së për stabilizimin e Maqedonisë dhe rajonit, bazuar në zgjerim dhe integrim. Në pah është kredibiliteti i të dy organizatave. Ato nuk duhet të lejojnë që të bijnë viktimë e një mosmarrëveshjeje të koklavitur, ku përfshihet një nga anëtarët e tyre.²⁰

D. NDËRMJETËSIMI I OKB-SË

Sipas Marrëveshjes së Përkohshme, bisedimet mbi çështjen e emrit vijuan nën ndërmjetësuesin e ri të OKB-së, Matthew Nimetz, jurist amerikan dhe ish-zyrtar i lartë i Departamentit të Shtetit, i cili e trashëgoi këtë detyrë nga Vance më 1999. Që atëherë negociatat janë zvarritur, herë më intenzivisht e herë jo, ndërsa herë Greqia e herë Maqedonia kanë treguar më shumë fleksibilitet. Shumica e ideve që janë shfaqur kurrë nuk kanë arritur domenin publik. Nimetz ka bërë një sërë propozimesh konfidenciale, por asnjëra nuk ka arritur që të bashkojë të dy palët në të njëjtën platformë. Në mars 2005, ai sugjeroi që emri për përdorim në OKB të jetë “Republika Makedonija – Skopje” në maqedonisht dhe të mos përkthehet në asnjë gjuhë tjetër.²¹ Kjo u mirëprit nga Athina, por u refuzua nga Shkupi. Presidenti Crvenkovski, si dhe Kryeministri i atëhershëm Vlado Buckovski, qëndruan mbrapa të ashtuquajturës “formulës së dyfishtë”, sipas së cilës duhet të jetë një emër i pajtueshëm për marrëdhëniet bilaterale me Greqinë, kurse emri kushtetues i Maqedonisë “Repub-

¹⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, lideri i BDI-së Ali Ahmeti, Tetovë, korrik 2008.

¹⁶ Intervistë e Grupit të Krizave, Shkup, tetor 2008. Një numër bashkëbiseduesish theksuan se shqiptarët maqedonas kishin prituri të jenë shqiptarët e parë në NATO, para atyre në Shqipëri dhe Kosovë. Intervista të Grupit të Krizave, Shkup, tetor dhe nëntor, 2008.

¹⁷ Shqiptarët e Maqedonisë në përgjithësi kanë mirëkuptim për maqedonasit rreth çështjes së emrit, deri në një pikë. Arifi i tha Grupit të Krizave se shqiptarët duhet të shfaqin “simpati dhe solidaritet” me bashkëatdhtarët e tyre maqedonas, sidomos sa i përket njohjes së identitetit të tyre. Mirëpo, edhe pse e ndajnë dëshpërimin e maqedonasve me qëndrimin e Greqisë, ajo dha shpresë se do të “gjejnë forcë” për të arritur një kompromis rreth emrit të vendit, që do t’ia mundësonte ecjes së saj drejt NATO-s dhe BE-së. Intervistë e Grupit të Krizave, tetor 2008.

¹⁸ Një bashkëbisedues shqiptar etnik i tha Grupit të Krizave se në një ditë pushimi maqedonas në tetor, për herë të parë flamujt maqedonas valuan në qytetin e dominuar me shqiptarë të Tetovës. Intervistë e Grupit të Krizave, Shkup, tetor, 2008.

¹⁹ Disa bashkëbisedues vendorë e ndërkombëtarë shfaqën brengën se në qoftë se rriten frustrimet e shqiptarëve të Kosovës, për shkak të ngecjeve drejt implementimit të pavarësisë së Kosovës apo de facto ndarjes së veriut të dominuar nga serbët dhe pjesës tjetër të Kosovës, kjo mund të çojë deri te ndezja e frustrimeve të shqiptarëve etnikë në Maqedoni, sidomos nëse anëtarësimi në NATO dhe BE duket se po vonohet pambarimisht. Intervistat e Grupit të Krizave, tetor 2008.

²⁰ Një numër bashkëbiseduesish në Maqedoni shfaqën mendimin se komuniteti ndërkombëtar do të reagojë vetë në rast të hapjes së një konflikti, për të adresuar seriozisht mosmarrëveshjen rreth emrit.

²¹ Një tekst i propozimit, që u transmetua në mediat greke, tregohet në greqisht në “Macedonian Heritage” [“Trashëgimia maqedonase”], në www.macedonian-heritage.gr/Official/Documents/Nimetz.html.

lika e Maqedonisë” të përdoret për të gjitha marrëdhëniet e tjera bilaterale dhe multilaterale.²²

Në tetor 2005, Nimetz propozoi një variant të ri, shumë më të pëlqyeshëm për Shkupin por e refuzuar nga Athina: “Republika e Maqedonisë – Shkupi” për marrëdhënie bilaterale me Greqinë, “Republika Makedonija” në OKB, dhe “Republika e Maqedonisë” për përdorim vendor dhe marrëdhënie bilaterale me vendet të cilat tashmë e kanë njohur shtetin me atë emër.²³

E. AMBIENT PËRKEQËSUES

Pati kontakte e sugjerime të tjera, por asnjëra nuk solli rezultate. Sidoqoftë, një sërë ngjarjesh në vitet 2007 dhe 2008, i dhanë një urgjencë të re kërkimit për zgjidhje, e njëkohësisht e përkeqësuan atmosferën në të cilën janë zhvilluar bisedimet. Hapat e ndërmarrur nga Shkupi dhe nga Athina shpesh në shkatërrimin e atij besimi të paktë që ishte ndërtuar me nënshkrimin e Marrëveshjes së Përkohshme.

Një përgjegjësi e konsiderueshme për këtë bie mbi qeverinë maqedonase të Gruevskit, e zgjedhur në korrik 2006, e cila në fillim të vitit 2007 vendosi që të rrimërojë Aeroportin e Shkupit sipas Aleksandrit të Madh. Kjo u duk si një kalkulim për të rihapur zemërimin grek mbi përvetësimin, sipas tyre, të trashëgimisë helene.²⁴ Kjo provokoi reagim të furishëm nga Athina, e cila pohoi se ishte shkelje e Marrëveshjes së Përkohshme.²⁵ U raportua se Nimetz e kishte paralajmëruar Gruevskin se si rezultat i kësaj Greqia do të mund të tërhiqej nga Marrëveshja e Përkohshme, por kjo këshillë për kujdes nuk u mor parasysh. Ministri i Jashtëm Antonio Milososki deklaroi se kjo masë mund të “stimulojë një hap moderues përpara drejt diskutimeve që kanë të bëjnë me emrin”.²⁶ U morën edhe hapa të mëtejshëm me të cilët rrezikohej ofendimi i ndjeshmërisë greke, siç ishte vendosja e disa statujave të kohës klasike përpara ndërtesës së qeverisë në Shkup.²⁷ Pa marrë parasysh se sa e pakuptimtë mund t’u duket të tjerëve ndjeshmëria greke rreth trashëgimisë së Maqedonit antik, ajo është e njohur mirë në Shkup. Në një kohë kur bisedimet

rreth emrit ishin duke vazhduar, hapa të tillë ishin, të paktën, provokativ dhe nuk ndihmonin.

Provokimi rreth aeroportit të Shkupit kontribuoi në ngritjen e çështjes së emrit të Maqedonisë në përgatitjet për zgjedhjet parlamentare në Greqi në shtator 2007. Kryeministri Kostas Karamanlis u përgjigj, duke premtuar se “Shkupi nuk do t’i bashkangjitet asnjë organizate ndërkombëtare, përfshirë dhe NATO-n e BE-në, nëse nuk gjendet një zgjidhje mbi emrin që është e pëlqyeshme për të dy palët”.²⁸ Pas rizgjedhjes, me një shumicë të vogël parlamentare,²⁹ dhe nën presion nga opozita e djathtë dhe partia qendër-e majtë PASOK, Karamanlis nuk e kishte të lehtë të tërhiqej nga qëndrimi i tij gjatë zgjedhjeve. Çështja është aq eksploduese në Greqi sa që të rrezojë një qeveri të tërë.³⁰

F. PËRJASHTIMI NGA NATO

Pas zgjedhjeve, Athina vazhdoi me paralajmërimet e saj se ishte e gatshme të përdorë veton kundër hyrjes së Maqedonisë në NATO. Si duket, kishte vendosur që mundësia e anëtarësimit të fqit të saj ishte një shans tepër i mirë për të shtyrë drejt zgjidhjes së favorshme të kësaj çështjeje.³¹ Me zvarritjen e negociatave të OKB-së, për një kohë ishte dukur sikur momenti ishte kundër Athinës, pas njohjes së Maqedonisë nga më shumë se 120 shtete me emrin e saj kushtetues, duke përfshirë – triumf i posaçëm për Shkupin – SHBA-të në vitin 2004. Tani, me afrimin e samitit të NATO-s në Bukuresht në prill 2008, Athina e kapi këtë nismë. Si anëtar i NATO-s, dhe kështu me të drejtë vetoje mbi anëtarësimin e Maqedonisë, Greqia ishte në pozitë të fuqishme. Duke pasur parasysh drojën se ajo do të përdorte veton, Nimetz u rikyç në lojë për t’u munduar që të gjejë një zgjidhje, por prapë pa rezultate. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jaap de Hoop Scheffer vizitoi Athinën në mars 2008, siç u raportua, për të dekurajuar grekët dhe

²²Raportet në A1 TV, 8, 9, 10 dhe 12 prill 2005, dhe 8 tetor 2005.

²³Raportet në A1 TV, 8 tetor 2005; po ashtu intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë maqedonas, Shkup, nëntor 2008.

²⁴Shih *Balkan Insight*, BIRN, 18 janar 2007, www.birn.eu.com/en/66/10/2105/.

²⁵Neni 7/3 i Marrëveshjes së Përkohshme, shih më lartë.

²⁶*Balkan Insight*, 18 janar 2007.

²⁷Disa bashkëbisedues maqedonas shfaqën nervozizëm me vendosjen e statujave. Intervista të Grupit të Krizave, Shkup, tetor 2008.

²⁸Shih *Balkan Insight*, BIRN, 12 shtator 2007, <http://balkaninsight.com/en/main/news/4919>.

²⁹Partia Demokracia e Re e Karamanlisit fitoi 152 nga 300 ulëset në parlament. Partia kryesore opozitare PASOK fitoi 102.

³⁰Intervistë e Grupit të Krizave, komentator politik grek, Athinë, nëntor 2008.

³¹Ministrja e Jashtme greke Dora Bakoyannis e shfaqti këtë qëndrim në tetor 2007, kur tha se “ne duhet ta bëjmë të qartë se tashti jemi në një pikë kthesë ku Shkupi do të mund të pranojë një ftesë për t’iu bashkangjitur NATO-s. Është koha për vendime”. Karamanlisi po ashtu e përmendi këtë çështje gjatë takimit me Kancelaren gjermane Angela Merkel në muajt e njëjtë. E raportuar në *Balkan Insight*, BIRN, 15 tetor 2007, <http://balkaninsight.com/en/main/news/6039>.

për t'i paralajmëruar ata mbi pasojat për stabilitetin rajonal, në qoftë se nuk arrihet një marrëveshje.³²

Atë muaj, pas mbledhjes së ministrave të jashtëm të NATO-s në të cilën Athina e bëri të qartë se, në mungesë të një marrëveshjeje mbi emrin, ajo do të përdorte veton kundër anëtarësimit të Maqedonisë,³³ Uashingtoni po ashtu hyri në lojë, duke dërguar në Shkup Ndihmës Sekretarin e Shtetit për Çështje Evropiane Daniel Fried.³⁴ Edhe ambasadorja në NATO Victoria Nurland u mundua që para Bukureshtit të zgjidhë këtë problem. Edhe pse përdorimi i vetos do të dukej si shkelje e qartë e Marrëveshjes së Përkohshme, Greqia iu përmbajt qëndrimit të vet. Duke e parë këtë, Fried e nxiti Shkupin që të punojë drejt një kompromisi. Kështu, kërcënimi i Athinës e kishte transformuar argumentin. Përkundër shenjave paralajmëruese gjatë muajve paraprakë, Uashingtoni u kyç aktivisht shumë vonë në lojë. Në prag të samitit, raportohej se ajo ishte e vendosur që të sigurojë hyrjen e Maqedonisë, por se kjo vendosmëri nuk ishte e njëjtë me atë të shumicës së anëtarëve të aleancës.³⁵ Në të vërtetë, Franca mori anën e Greqisë, dhe përfundimisht pjesa tjetër e aleancës qëndroi e heshtur përballë insistimit të Athinës.³⁶

Me afrimin e samitit të Bukureshtit, Gruevski deklaroi se Maqedonia nuk do t'i nënshtrohej kërcënimit dhe se në qoftë se anëtarësimi i vendit në NATO bllokohet, vetë NATO-ja dhe rajoni do të dëmtoheshin.³⁷ E megjithatë, qeveria e tij u pajtua në Bukuresht me emrin "Republika e Maqedonisë (Shkup)", një zgjidhje kjo pak a shumë që ajo e kishte refuzuar në

vitin 2005, ndërsa Greqia e kishte pranuar. Mirëpo, duke e ndjerë veten në një pozitë shumë më të fuqishme, Athina e refuzoi ofertën, duke insistuar në veçanti që emri i pajtuar të aplikohet në të gjitha marrëdhëniet ndërkombëtare të Maqedonisë, bilaterale si dhe multilaterale.³⁸

Diplomacia e minutës së fundit, që të paktën t'ia lejojë anëtarësimin Maqedonisë si "ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë", dështoi. Askush nuk e vuri në dyshim plotësimin e kriterëve të Shkupit për anëtarësim në NATO – deklarata e samitit e lavdëroi "përkushtimin e saj ndaj vlerave të NATO-s dhe operacioneve të Aleancës". Por ajo konkludoi se ftesa "do t'i dorëzohej menjëherë pas arritjes së një marrëveshjeje të kënaqshme për të dy palët rreth çështjes së emrit".³⁹ Delegacioni i Maqedonisë u largua, ndërsa Milososki deklaroi se "kërkesa e Maqedonisë për anëtarësim në NATO u dënua, jo për arsye të asaj që kemi bërë, por për arsye të asaj se kush jemi ne".⁴⁰

Bukureshti krijoi një realitet të ri në tregimin e stërgjatur rreth emrit të Maqedonisë. Së pari, mirëkuptimi që nga Marrëveshja e Përkohshme se mosmarrëveshja nuk do të vonojë integrimin e vendit në organizatat ndërkombëtare, është thyer. Së dyti, qëndrimi i Greqisë dhe konfidenca e saj përvetësuan një vetëbesim shumë të madh. Pas ballafaqimit me SHBA-të, Athina e pati ndjesinë se ishin tejkaluar të gjitha kufizimet rreth kërkesave të saj. Ambasadori grek në Uashington deklaroi se "NATO-ja e mbështeti qëndrimin tonë... Kërkesa për të zgjidhur çështjen e emrit nuk është më vetëm qëndrim grek, por tani është qëndrim i NATO-s dhe çështje multilaterale".⁴¹ Duke lënë anash konkluzionin e NATO-s në Bukuresht, së paku një shtet anëtar i NATO-s refuzoi që të pranojë pohimin se mosmarrëveshja ishte bërë tani çështje multilaterale, ose të pranojë zgjidhjen e saj si

³² *Balkan Insight*, BIRN, 3 mars 2008, citat i raporteve të mediave greke, <http://balkaninsight.com/en/main/news/8322>.

³³ *Balkan Insight*, BIRN, 6 mars 2008, <http://balkaninsight.com/en/main/news/8429>.

³⁴ *Balkan Insight*, BIRN, 8 mars 2008, <http://balkaninsight.com/en/main/news/8466>.

³⁵ *Balkan Insight*, BIRN, 2 prill 2008, <http://balkaninsight.com/en/main/news/9071>.

³⁶ Presidenti francez Nicolas Sarkozy konfirmoi përkrahjen e tij për qëndrimin e Greqisë pak para Bukureshtit. *Balkan Insight*, BIRN, 14 mars 2008, <http://balkaninsight.com/en/main/news/8630>. Një diplomat nga një shtet anëtar tjetër i NATO-s i tha Grupit të Krizave se, me përkrahjen e Francës për Greqinë, ishte shumë vështirë që të ushtrohej presion efektiv mbi Athinën. Intervistë e Grupit të Krizave, Shkup, tetor 2008. Spekulumet për motivimet e Sarkozyt – i cili po ashtu është kundër zgjerimit të mëtejshëm të BE-së përderisa Unioni është ende duke pasur probleme me ca çështje të vështira të qeverisjes – kanë prekur në interesat komerciale franceze me Greqinë dhe aluzionet për trashëgiminë e vetë familjes së tij nga Selaniku.

³⁷ *Balkan Insight*, BIRN, 25 mars 2008, <http://balkaninsight.com/en/main/news/8897>.

³⁸ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtar i lartë grek, nëntor 2008, dhe zyrtarë ndërkombëtarë dhe vendorë, Shkup, tetor dhe nëntor 2008.

³⁹ "Bucharest Summit Declaration Issued by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council", ["Deklarata e Samitit të Bukureshtit, e lëshuar nga Kryesuesit e Shteteve dhe Qeverive që morën pjesë në mbledhjen e Këshillit Atlantik Verior"], 3 prill 2008, www.summitbucharest.ro/en/doc_201.html.

⁴⁰ BBC News, 4 prill 2008, <http://news.bbc.co.uk/1/hi/world/europe/7329963.stm>.

⁴¹ Ambasadori i Greqisë në SHBA, Alexadros Mallias, duke mbajtur fjalim publik në Georgetown University, 15 prill 2008, citat nga Edward P. Joseph, "Averting the Next Balkan War: How to Solve the Greek Dispute over Macedonia's name" ["Shmangia e luftës së radhës në Ballkan: si të zgjidhet mosmarrëveshja greke rreth emrit të Maqedonisë"], *Internationale Politik*, verë 2008.

kusht për anëtarësimin e Maqedonisë.⁴² Megjithatë, Athina kishte paralajmëruar se do të bllokonte hyrjen e Maqedonisë në NATO në qoftë se nuk realizoheshin kërkesat e saj maksimale mbi atë çështje.

G. ZGJIDHJA NË PRITJE

Përpjekjet për të ringjallur negociatat dhe për të siguruar hyrjen e Maqedonisë në NATO fillimisht u ngadalësuan për shkak të vendimit të Gruevskit për të thirrur zgjedhjet e parakohshme parlamentare në korrik 2008, e pasuar kjo nga një vonesë tjetër gjatë formimit të qeverisë. Tendosja bilaterale u rrit po ashtu kur Maqedonia ia dërgoi një sërë letrash qeverive dhe organizatave ndërkombëtare, duke protestuar mbi qëndrimin e Greqisë në Bukuresht, gjë që kryesisht vetëm sa irritoi pranuesit e letrave.⁴³ Shkupi e ngriti edhe çështjen e të drejtave të pakicës maqedonase në Greqinë veriore dhe kthimin e pronave të maqedonasve të cilët e kishin lënë Greqinë pas luftës civile.⁴⁴

Mohimi i të drejtës së folësve sllavë në Greqinë veriore që të identifikohen si maqedonas është përmendur vazhdimisht gjatë viteve, përfshirë edhe në raportin vjetor për të drejtat e njeriut të Departamentit të Shtetit Amerikan për Greqinë.⁴⁵ Pa dyshim, kjo çështje kërkon vëmendje. Efektivisht, Greqia nuk është duke respektuar kushtet mbi tretmanin e pakicave që kërkohen nga BE-ja për anëtarët e saj të ardhshëm. Sidoqoftë, përmendja e kësaj çështjeje pas Bukureshtit është bërë me qëllim të rritjes së temperaturës rreth çështjes së emrit, kështu që duke pasur parasysh kontekstin nuk ishte veprim i mençur. Duke vazhduar me ndjekjen e një strategjie këmbëngulëse, në janar 2009, qeveria maqedonase lajmëroi se do të emëronte autostradën kryesore veri-jug sipas Aleksandrit të Madh.⁴⁶

⁴² Intervistë e Grupit të Krizave, diplomat perëndimor, Shkup, tetor 2008.

⁴³ Për shembull, pak kohë pas mbledhjes së Bukureshtit, Shkupi i dërgoi letra të gjithë anëtarëve të NATO-s përveç Greqisë. Përfshirja e Greqisë u përshkrua nga zyrtarë të NATO-s si "i papjekur". *Balkan Insight*, BIRN, 11 prill 2008, <http://balkaninsight.com/en/main/news/9308>.

⁴⁴ Në korrik Gruevski i shkruajti mbi këtë temë Karamanlisit dhe Presidentit të Komisionit Evropian Jose Manuel Barroso. *Balkan Insight*, BIRN, 18 korrik 2008, <http://balkaninsight.com/en/main/news/11916/>; and 21 July 2008, <http://balkaninsight.com/en/main/news/11936>.

⁴⁵ Shih "Country Report on Human Rights Practices, 2007" ["Raporti i vendit mbi praktikën e të drejtave të njeriut"], lëshuar më 11 mars 2008, www.state.gov/g/drl/rls/hrrpt/2007/100562.htm.

⁴⁶ "Macedonia Names Highway 'Alexander of Macedon'" ["Maqedonia e emëron autostradën 'Aleksandri i Maqedon-

Pas zgjedhjeve në Maqedoni, SHBA-të mbështeti një përpjekje të re të Nimetz për të gjetur një zgjidhje.⁴⁷ Më 8 tetor Nimetz prezantoi një propozim të ri, i cili, edhe pse nuk u bë zyrtarisht publik, megjithatë u mor vesh. Ai propozim përbëhej nga katër elemente, duke reflektuar kështu format e kërkuara për anëtarë të OKB-së. Emri formal do të ishte "Republika e Maqedonisë Veriore" ndërsa emri i shkurtër "Maqedonia Veriore". Sa i përket mbiemrave që do të përshkruanin nacionalitetin dhe gjuhën, do të ekzistonin dy alternativa: "maqedonas" si dhe nacionaliteti dhe gjuha "e Republikës së Maqedonisë Veriore". Në përpjekje për t'iu përgjigjur shqetësimeve greke, një shënim do të pohonte se emri "maqedonas" nuk bartte implikime të ekskluzivitetit mbi përdorimin e atij termi. Për përdorim të brendshëm, Maqedonia do të vazhdonte që të përdorte emrin e saj kushtetues, "Republika Makedonija", në shkrimin qirilicë. Këshilli i Sigurimit i OKB-së do të rekomandonte se shtetet e treta të përdornin emrin e OKB-së, ndërkombëtar, në marrëdhëniet zyrtare bilaterale.

Të dy palët reagojnë me ftohtësi.⁴⁸ Në këtë pikë, ekzistojnë tri aspekte rreth mosmarrëveshjes:

- *Emri i vendit*. Si u pa në samitin e Bukureshtit, Shkupi është i gatshëm që të bëjë kompromis në këtë temë. Derisa propozimi i Nimetz për "Republikën e Maqedonisë Veriore" nuk është opsioni më i pëlqyeshëm as për Shkupin e as për Athinën, këtu me siguri ka hapësirë për një marrëveshje ose diç të ngjashme. Athina insiston që cilësimi gjeografik duhet të vijë përpara fjalës "Maqedoni".⁴⁹

isë"], *Balkan Insight*, BIRN, 6 janar 2009, <http://balkaninsight.com/en/main/news/15863/>.

⁴⁷ Për përpjekjet e administratës së Bushit, shih Sinisa-Jakov Marusic, "Momentum Slips in Macedonia-Greece Row" ["Ikën momentin në përleshjen Maqedoni-Greqi"], *Balkan Insight*, BIRN, 16 tetor 2008, <http://balkaninsight.com/en/main/analysis/14018>. Ndihmës Sekretari amerikan për Çështje Evropiane Daniel Fried e nxitu Shkupin që të pranojë propozimin e fundit të Nimetz, për t'iu shmangur izolimit. *Vecer*, 29 tetor 2008.

⁴⁸ Edhe Shkupi edhe Athina iu shmangën refuzimit të menjëhershëm të propozimit të Nimetz, por deklaruan se aty kishte elemente problematike. Ministria e Jashtme greke Dora Bokayannis para komisionit parlamentar për punë të jashtme dhe mbrojtje, raportuar nga MPB, 29 tetor 2009, citat në raporte të mediave greke; deklarata nga Presidenti maqedonas Branko Crvenkovski dhe Kryeministri Gruevski, raportuar nga *Balkan Insight*, BIRN, 16 tetor 2008, <http://balkaninsight.com/en/main/news/14030>.

⁴⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë grek, shtator 2008. Insistimi për kualifikimin gjeografik, që vjen menjëherë para zbatimit të emrit në gjuhën angleze, por, arsye gramatike, jo patjetër edhe në tërë gjuhët e tjera. Për shembull, propozimi i fundit i Nimetz e jep përkthimin francez të termi "Republika e Maqedonisë Veriore" si "République de

Mirëpo ka një mungesë konsensusi në mes presidentit dhe kryeministrit maqedonas në lidhje me atë se a të lëshojë pe Shkupi në këtë pikë pa dëshmi të mëtijshme për vullnetin e Greqisë për treguar gatishmëri për kompromise në aspekte të tjera. Ndjenja në mesin e zyrtarëve në Shkup është se vullneti i tyre për të bërë kompromise, si në rastin e Bukureshtit, është ballafaquar me këmbëngulje nga ana tjetër.⁵⁰ Mosmarrëveshja ndërmjet kryeministrit dhe presidentit është e lidhur për zgjedhjet presidenciale dhe lokale në mars 2009. Anketat sugjerojnë se vija radikale e Gruevskit rreth çështjes së emrit është temë popullore.⁵¹

- *Hapësira mbi përdorimin e emrit.* Hezitimi i qeverisë maqedonase për të zbuluar qëndrimin e saj të plotë negociues, pa dëshmi të vullnetit grek për të lëvizur përpara, ka të bëjë me kthimin e saj prapa, në formulën e dyfishtë.⁵² Crvenkovski tashti e kritikon qeverinë për këtë gjë, duke e konsideruar që ky qëndrim i ka bllokuar negociatat.⁵³ Por në realitet, Shkupi është bërë më fleksibil. Nëse Athina bën koncesione mbi njohjen e identitetit maqedonas, ajo me siguri do të hiqte dorë nga formula e dyfishtë dhe do të pranonte përdorimin e emrit të pranuar në të gjitha organizatat ndërkombëtare, në esencë duke zëvendësuar emrin e përkohshëm “ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë”.

Megjithatë, Athina insiston që emri i pëlqyer të përdoret në të gjitha marrëdhëniet ndërkombëtare, bilaterale dhe multilaterale, si dhe për të identifikuar origjinën e produkteve të prodhuara në Maqedoni. Ajo mbase do të pranonte përdorimin e brendshëm nga Maqedonia të emrit të saj kushtetues në gjuhën maqedonase.⁵⁴ Qeveria maqedonase heziton që të

pranojë përdorimin e emrit të pëlqyer në marrëdhëniet bilaterale. Më shumë se 120 shtete tashmë e kanë njohur vendin me emrin e vet kushtetues, gjë që shihet si sukses i madh në Shkup. Derisa Crvenkovski mund të jetë më i gatshëm që të lëshojë pe në këtë pikë, zgjedhjet presidenciale që po afrohen dhe popullariteti i qëndrimit të Gruevskit sugjerojnë se ka gjasa që qëndrimi i Shkupit të vendoset nga qeveria.

- *Nacionaliteti dhe gjuha.* Mbiemrat për nacionalitetin dhe gjuhën kanë dalë në pah si kritik pas Bukureshtit. Pasi që Shkupi e ka zbutur qëndrimin e tij rreth emrit të vendit, ai ka insistuar që nacionalitetin dhe gjuhën duhet të njihen në OKB si maqedonase, pa kualifikime. Presidenti dhe kryeministri e ndajnë këtë qëndrim.⁵⁵ Rëndësia për maqedonasit qëndron në dyshimin e tyre, jo të paarsyeshëm duke pasur parasysh insistimet e vazhdueshme greke mbi artificialitetin e kombit maqedonas, se mbrapa kundërshtimeve greke për emrin qëndron mohimi i vetë kombit maqedonas. Athina u orvat që ta mbante nacionalitetin dhe gjuhën jashtë agjendës së bisedimeve të OKB-së, duke theksuar se ato nuk ishin pjesë e mandatit të Nimetz.⁵⁶ Heziton që të pranojë kërkesat e Shkupit, duke preferuar formulën “qytetarët e Maqedonisë Veriore”, derisa ndoshta duke pranuar se gjuha do të mund të quhej “Makedonski”, në maqedonishte, pa u përkthyer.⁵⁷

Pas dështimit të propozimit të fundit të Nimetz për të gjetur përkrahje në Shkup apo Athinë, duket se ka shansa të vogla për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në të ardhmen e afërt, dhe se aktiviteti i fundit diplomatik është shpenzuar. Të dyja palët kanë përfunduar se mungon vullneti i mirë i nevojshëm i palës tjetër.⁵⁸ Kombinimi i provokimeve të Shkupit, duke filluar me emrin e aeroportit, dhe shkelja nga Athina e Marrëveshjes së Përkohshme në Bukuresht, ka zvogëluar besimin e dyanshëm në nivel që nuk është parë për më shumë se një dekadë.

Macédoine du Nord.” Shkupi do të preferonte vendosjen e kualifikimit para fjalës “Republikë”, si në “Northern Republic of Macedonia”, por me siguri do të lëshonte pe në këtë pikë. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë maqedonas, Shkup, nëntor 2008.

⁵⁰ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të lartë maqedonas, Shkup, nëntor 2008.

⁵¹ Shih për shembull, anketën nga Instiuti për Demokraci, raportuar në *Balkan Insight*, BIRN, 5 dhjetor 2008, www.balkaninsight.com/en/main/news/15330/, ku shënohet 67 përqind përkrahje për vendimin e qeverisë për të dërguar Greqinë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë rreth çështjes së NATO-s, me 18 përqind kundër. Anketa e njëjtë tregon se Gruevski është politikani më i popullarizuar në vend, me 30.7 përqind aprovim.

⁵² Formula e dyfishtë, si është e përsëritur më lartë, përfshin një emër të pëlqyer për marrëdhëniet bilaterale me Greqinë, dhe përdorimin e emrit kushtetues të Maqedonisë, “Republika e Maqedonisë” për marrëdhëniet e tjera bilaterale dhe multilaterale.

⁵³ Raportuar në *Dnevnik*, 4 nëntor 2008.

⁵⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë grek, nëntor 2008.

⁵⁵ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të lartë maqedonas, Shkup, tetor dhe nëntor 2008.

⁵⁶ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë ndërkombëtar, Nju Jork, nëntor 2008.

⁵⁷ Duke u dukur se konfirmonte shqetësimet maqedonase për mosnjohjen greke të ekzistencës së tyre si komb, një zyrtar i lartë grek tha se ai nuk kishte dijeni për “gjuhën maqedonase”, se ekzistonte gjuha bullgare dhe greke, por se maqedonishtja nuk ishte “gjuhë origjinale”. Ai tha se, si gjest i vullnetit të mirë, Athina mbase do të mund të pranonte përdorimin e termit “Makedonski” për gjuhën, mirëpo çështja e nacionalitetit ishte më e vështirë, dhe se në atë rast ajo nuk do të mund të përkthehej. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë grek, nëntor 2008.

⁵⁸ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të lartë maqedonas dhe grek, nëntor 2008.

Duke pasur parasysh këtë atmosferë helmuese, në nëntor 2008, qeveria maqedonase e paditi Greqinë në Gjyqin Ndërkombëtar të Drejtësisë (GjND) për shkelje të Marrëveshjes së Përkohshme.⁵⁹ Ministri i Jashtëm Milososki theksoi se masat e gjykatës kishin të bënin jo me vetë çështjen e emrit, por me parimin, të deklaruar në Marrëveshjen e Përkohshme, që Greqia nuk duhet të bllokojë hyrjen e vendit në organizata ndërkombëtare me emrin e përkohshëm. Shkupi kërkoi nga GjND-ja që ta urdhërojë Greqinë të respektojë marrëveshjen e vitit 1995, dhe “të pushojë së insistuari nga kundërshtimi i çfarëdo mënyre, drejtpërdrejtë apo tërthorazi”, i anëtarësisë së Maqedonisë në NATO apo në cilëndo organizatë tjetër ndërkombëtare.⁶⁰

Edhe pse Milososki llogariti që rasti mund të marrë tri deri në pesë vjet,⁶¹ qeveria u duk se konkludoi se, pa prospekte të tashme mbi zgjidhjen e emrit apo bllokim të anëtarësimit në NATO dhe BE, vendimi i GjND-së ishte mënyra për të rivendosur dhe rimarrë iniciativën.⁶² Shkupi mendon se ka një rast të fuqishëm, edhe pse janë ngritur pyetje mbi faktin se ishte premtimi për përdorimin e vetos greke, e jo vetë vetoja që dërgoi deri te marrja e konkluzioneve negative të samitit mbi aplikimin për anëtarësim të Maqedonisë.

Athina u përgjigj duke thënë se, me dorëzimin e rastit para GjND-së, Shkupi po demonstronte se nuk ishte i interesuar në zgjidhjen e shpejtë të mosmarrëveshjes rreth emrit. Ajo gjithashtu pohoi se Maqedonia vetë e kishte shkelur disa herë Marrëveshjen e Përkohshme.⁶³ Ajo e konsideron rrimërimin e Aeroportit të Shkupit si shkelje të atij dokumenti dhe përdorimin nga Shkupi brenda OKB-së të emrit të saj kushtetues,

e jo emrit të përkohshëm, si shkelje të frymës së saj.⁶⁴ Në fund të dhjetorit 2008, Athina dha shenja se kishte gjasa se do të dorëzonte një kundër-padi para GjND-së rreth shkeljeve të tilla të Marrëveshjes.⁶⁵

Një përdorim më i shpeshtë i GjND-së si bazament i të drejtës ndërkombëtare është zhvillim i mirëpritur. Shtetet kanë të drejtë që të kërkojnë lehtësi juridike, dhe një hap i tillë zakonisht duhet të mirëpritet si mënyrë për qetësimin e situatave të tendosura dhe si kontribut drejt zgjidhjes paqësore të mosmarrëveshjes. Mirëpo, përveç motivimeve të mundshme të Maqedonisë dhe Greqisë në qasjet e tyre drejt Gjyqit, rrethanat specifike të mosmarrëveshjes së tanishme tregojnë se opsioni i involvimit të GjND-së mund të mos jetë produktiv.

Derisa të dy qeveritë deklaruan se do të vazhdonin me negociatat e OKB-së, prodecurat e gjyqit rrezikojnë një shtyrje të mëtejshme të integritit të Maqedonisë në BE dhe NATO, përveç nëse shtetet anëtare i bëjnë presion Greqisë që të ndalojë taktikat e saj bllokuese. Mirëpo kjo mbase nuk ka gjasa që të ndodhë, kur të kihet parasysh se disa elemente të mosmarrëveshjes janë para vendimit gjyqësor. Mund të pritët që vonesa e parashikuar do të dëmtojë marrëdhëniet e dy palëve, e për pasojë edhe paqen e stabilitetin në rajon. Prandaj të dy palët duhet të inkurajohen që t'i japin përparësi negociatave dhe të jenë të gatshme që të tërheqin rastet e tyre (apo rastet me të cilat janë kërcënuar) në një kohë të duhur si stimulim për të arritur një marrëveshje diplomatike rreth çështjes së emrit.

III. INTEGRIMI NË BE

Tash e disa vjet Maqedonia është agazhuar për integrimin e saj në BE, pa u ndikuar nga mosmarrëveshja rreth emrit. Ajo e siguroi statusin e anëtarit kandidat në dhjetor 2005, sukses ky që reflektonte përkushtimin e fuqishëm politik për të avansuar ambiciet integruese të vendit dhe rrjedhimisht për të mbështetur stabilizimin e saj pas konfliktit të vitit 2001. Natyra e hapët e përkushtimit, pa datë për fillimin e bisedimeve për anëtarësim, tregonte për sfidat e konsiderueshme me të cilat ballafaqohet Maqedonia për t'u bërë kandidat kredibil.⁶⁶ Mirëpo, deri te fillimi i samitit të NATO-s në Bukuresht, në përgjithësi mendohej se, derisa ka progres të mjaftueshëm në të gjitha kërkesat teknike të integritit të

⁵⁹ Sipas Nenit 21 të Marrëveshjes së Përkohshme, çfarëdo ndryshimi apo mosmarrëveshje që lind ndërmjet palëve në lidhje me implementimin e Marrëveshjes, mund të dorëzohet nga cilado prej tyre në GjND. Në këtë rast, gjykimi i marrur nga gjykata do të ishte ligjërishit i detyrueshëm mbi palët.

⁶⁰ Deklaratë për shtyp, GjND, 17 nëntor 2008, www.icj-cij.org/docket/files/142/14881.pdf. Shih po ashtu *Balkan Insight*, BIRN, 17 nëntor 2008, <http://balkaninsight.com/en/main/news/14845>.

⁶¹ Shih *Balkan Insight*, BIRN, 8 dhjetor 2008, <http://balkaninsight.com/en/main/news/15374>; www.b92.net/eng/news/region-article.php?yyyy=2008&mm=12&dd=08&nav_id=55584.

⁶² Por disa në Shkup menduan se rasti në GjND vetëm se do të shtynte zgjidhjen e kësaj çështjeje. Shih, për shembull, komentin nga Sinisa-Jakov Marusic, “World Court Suit Heats up Macedonia Name Row” [“Gjykata Botërore e përmdez përleshjen mbi emrin e Maqedonisë”], *Balkan Insight*, BIRN, 19 nëntor 2008, <http://balkaninsight.com/en/main/analysis/14924>.

⁶³ Deklaratë e ministrisë së jashtme greke, raportuar në *Kanal 5*, 17 nëntor 2008.

⁶⁴ Shih letrën e 27 nëntorit nga përfaqësuesi i përhershëm i Greqisë në OKB për Sekretarin e Përgjithshëm.

⁶⁵ A1 televizioni, 28 dhjetor 2008.

⁶⁶ Shih Brifingun për Evropë të Grupit të Krizave Nr. 41, *Maqedonia: duke u lëkundur drejt Evropës*, 12 janar 2006.

BE-së, Maqedonia do të ecte përpara mbi bazë të njëjtë me atë që kishte pasur kur kishte hyrë në organizatat e tjera ndërkombëtare, d.m.th. si “ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë”.

A. PLOTËSIMI I STANDARDEVE

Për të nxitur qeverinë që të arrijë standardet për të hapur bisedimet për anëtarësim, në shkurt 2008, BE-ja miratoi Partneritetin për Anëtarësim me Maqedoninë, në të cilën radhiten tetë prioritetet afat-shkurta.⁶⁷ Komisioni Evropian dha një vlerësim mikës të implementimit të tyre në Raportin e Progresit 2008.⁶⁸ Aty shënohen të arritura solide në disa fusha, përfshirë reformat në drejtësi dhe polici, luftën kundër korrupsionit dhe profesionalizimin e shërbimit civil. Avansimet drejt arrijtes së standardeve për liberalizimin e vizave u përmendën si sukses i theksuar.⁶⁹ Mirëpo ngecjet, ato që kanë të bëjnë me standardet politike, ishin po ashtu të nënvizuara.⁷⁰ Përfundimet e Komisionit Evropian të 8-9 dhjetorit 2008 riafirmuan shumicën e pikave të njëjta, përfshirë edhe nevojën për më shumë punë në pavarësinë dhe efikasitetin e gjyqësisë, korrupsioni mbetet “një problem veçanërisht serioz”, dhe se kishte pak progres drejt sigurimit të të drejtave të pakicave më të vogla, sidomos romëve. Ajo çka është më e rëndësishmja, Komisioni nuk rekomandon datë për të hapur negociatat për anëtarësim.

Komisioneri për Zgjerim Olli Rehn dhe Përfaqësuesi Special i BE-së në Maqedoni, Erwan Fouere, theksuan

⁶⁷ Prioritetet e identifikuara nga Këshilli i BE-së, në vendimin e tij të 18 shkurtit 2008, përfshijnë: “një dialog konstruktiv dhe përfshirës, në veçanti në fushat të cilat kërkojnë konsensus në mes të të gjitha partive politike”; “implementim efektiv të ligjit për policinë”; reforma gjyqësore; implementim të qëndrueshëm të legjislacionit kundër korrupsionit; profesionalizim dhe depolitizim të shërbimit civil; një ambient të përmirësuar për biznes, nëpërmjet sundimit të ligjit dhe reformave të ligjit; dhe pavarësi të përforcuar të agjencive rregulluese dhe mbikëqyrëse. Për një listë të plotë, shih vendimin e Këshillit, <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2008:080:0032:0045:EN:PDF>.

⁶⁸ “The Former Yugoslav Republic of Macedonia, 2008 Progress Report” [“Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Raporti i Progresit 2008”], Bruksel, 5 nëntor 2008. Dokumenti i plotë në http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/press_corner/key_documents/reports_nov_2008/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia_progress_report_en.pdf.

⁶⁹ Liberalizimi i vizave nga ana e BE-së për Maqedoninë pritet të ecë përpara më 2009, pas një raporti pozitiv nga Komisioni Evropian mbi suksesin e vendit në plotësimin e kriterëve, si u paralajmërua nga Përfaqësuesi Special i BE-së Erwan Fouere në fillim të dhjetorit 2008. Agjencia Informativë Maqedonase, 5 dhjetor 2008.

⁷⁰ “Raporti i Progresit 2008”.

se Maqedonia kishte mbetur mbrapa posaçërisht në arrijtes e kriterëve politike.⁷¹ Në veçanti, menaxhimi i dobët i zgjedhjeve parlamentare të vitit 2008 ishte parë si ngecje serioze drejt shpresës për integrim në BE, kështu që mbajtja e zgjedhjeve të mira u bë standard i nëntë për BE. Vendimi për të aranzhuar votë të menjëhershme ishte marrur përkundër këshillave të zyrtarëve ndërkombëtarë, të cilët e konsideronin këtë si dekoncentrim nga reformat e nevojitura për të aritur standardet e BE-së, me pak gjasa për të kontribuar në qetësimin e ambientit politik pas dështimit për anëtarësim në NATO.⁷²

Maqedonia ka një shënim jo të kënaqshëm të zgjedhjeve të njollosuar me dhunë dhe shkelje të rënda, ndërsa në qershor 2008 u duk se vendi madje e tejkaloi edhe vetveten. Vëzhguesit ndërkombëtar të zgjedhjeve shënuan se:

Incidente të shumta e të dhunshme në vende të dominuara nga shqiptarë etnikë, para dhe gjatë periudhës zyrtare të fushatës, prodhuan një ambient kërcënimi. Dështimi për të marrë hapa efektivë parandalues, nga shumë vëzhgues iu atribuua zyrtarëve të lartë të policisë në veri dhe perëndim të vendit, të cilët në mënyrë të hapur përkrahnin njëri parti shqiptare etnike. Fakti se akte të tilla mbetën të paadresuara nga autoritetet lokale dhe nacionale, kontribuoi në një kulturë të pacenueshmërisë gjatë zgjedhjeve të 1 qershorit.⁷³

Gjatë ditës së zgjedhjeve, “dhuna e organizuar dhe kërcënimet e penguan votimin në shumë vende të dominuara me shqiptarë, duke lënë një person të vdekur dhe disa të plagosur”. Vëzhguesit po ashtu shënuan “përgjigje siç duket partiake të policisë ndaj incidenteve që kishin të bënin me zgjedhjet” në vendet etnike maqedonase.⁷⁴ U raportua që policia, sidomos njësitet speciale “Alfa”, kishin marrur pjesë aktivisht në dhunë.⁷⁵ Pas ankesave nga BDI, atëherë partia kryesore opozitare shqiptare, se dhuna e ushtruar ishte bërë në emër të Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH) në pushtet, Alfati u tërhoqën nga qytetet e Tetovës, Gostivarit e Kumanovës gjatë rizgjedhjeve të mbajtura në 187

⁷¹ Citat në *Utrinski Vesnik*, 6 dhe 7 nëntor 2008.

⁷² Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë ndërkombëtarë, Shkup dhe Bruksel, tetor 2008.

⁷³ “Final Report on the Early Parliamentary elections of 1 June 2008” [“Raporti Final mbi zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 1 qershorit 2008”], Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë/Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut (OSCE/ODIHR), në www.osce.org/documents/odihr/2008/08/32619_en.pdf.

⁷⁴ Po aty.

⁷⁵ Intervista të Grupit të Krizave, Shkup dhe Tetovë, qershor dhe korrik 2008.

vende votimi më 15 qershor, kur vëzhguesit shënuan sigurim të shtuar dhe ambient më të qetë.⁷⁶

Në Raportin e Progresit, të botuar në nëntor 2008, Komisioni Evropian shënoi hapat e ndërmarrur nga autoritetet për adresimin e ngecjeve të shënuara nga vëzhguesit e zgjedhjeve. Hetimet kishin filluar në 34 raste, që rezultuan në dënime me burgim për pesëm-bëdhjetë persona, dhe me raste kundër 143 të tjerëve. Njëzet e tetë zyrtarë të policisë ishin suspenduar, ndërsa paditë kriminale ishin ngritur kundër njëmbëdhjetë prej tyre. Kjo gatishmëri për të dënuar keqbërësit e dhunës së zgjedhjeve bie në kontrast pozitiv me vitet e fundit. Mbajtja e rizgjedhjeve në shumë vende dy javë pas zgjedhjeve të para, si dhe hapat e ndërmarrë për të ofruar një ambient më të shëndoshë, u vlerësuan si pozitivë, ashtu siç u vlerësuan edhe masat për të adresuar rekomandimet e Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut të OSBE-së (ODIHR), duke përfshirë dhe amandamentimin e kodin zgjedhor në tetor. Megjithatë, Rehn ia ka bërë të qartë Maqedonisë se zgjedhjet e mira janë “kërkesë bazike” dhe se vëmendja tani do të jetë në votën lokale dhe presidenciale të vitit 2009.⁷⁷

Një fushë tjetër për t’u përmendur si shqetësuese nga BE-ja ishte dialogu politik. Raporti i Progresit shënoi bojkote parlamentare nga partitë opozitare, duke përfshirë një nga blloku kryesor etnik maqedonas, e udhëhequr nga Unioni Social-Demokratik (SDSM) nga 17 korriku deri më 4 gusht 2008, gjatë së cilës qeveria përdori një procedurë emergjente për të shtyrë përpara 172 ligje, përfshirë edhe disa që ishin të kundërshtueshme. Zyrtarët ndërkombëtarë e panë këtë si goditje ndaj praktikës demokratike dhe keqësim i një klime tashmë të vështirë politike.⁷⁸ Më vonë qeveria e pranoi gabimin, por nguli këmbë se kishte dialog politik, dhe se partitë kryesore kishin punuar së bashku, për shembull në amandamentimin e kodit zgjedhor.⁷⁹ Sido që të jetë, atmosfera politike toksike po ashtu mund të vështrohet si dështim i presidentit dhe kryeministrit për të arritur konsensus rreth çështjes së emrit, me

përrjashtim të një rezolute parlamentare të 3 nëntorit mbi këtë temë.⁸⁰ Para se të trajtohet si çështje me rëndësi kombëtare, kjo çështje ka qenë temë e marrjes së shumë poenave politik.⁸¹

B. ANËTARËSIMI NË BE DHE ÇËSHTJA E EMRIT

Duke pasur parasysh ngecjet e theksuara në Raportin e Progresit, zyrtarët e BE-së thonë se, edhe nëse mosmarrëveshja rreth emrit do të zgjidhej, Maqedonia ende nuk i ka plotësuar kërkesat për të hapur negociatat për anëtarësim.⁸² Ky është një dëshpërim i madh për qeverinë, e cila shpresonte që para fundit të vitit 2008 do të caktohej data. Sugjetimet se progresi për anëtarësim ishte bllokuar vetëm për arsye të çështjes së emrit u pranuan me irritim nga zyrtarët e BE-së, të cilët e konsideruan këtë si mohim të qëllimshëm të dështimeve të cilat duhet të përballen, veçanërisht duke konsideruar fiaskon e zgjedhjeve të qershorit 2008.⁸³ Me të vërtetë, edhe nëse progresi i të tetë kriteret e tjera do të konsiderohej i mjaftueshëm, BE-ja do të kishte të drejtë të insistonte në dëshmi konkrete nga anketat e vitit 2009 që do të tregonin se problemet serioze të zgjedhjeve janë adresuar.

Megjithatë, që nga samiti i NATO-s në Bukuresht, Athina me të vërtetë e ka bërë zgjidhjen e çështjes së emrit si kusht shtesë për progres të mëtutjeshëm në integrimin në BE. Në samitin e BE-së më 19-20 qershor 2008, ajo pati sukses, përkundër kundërshtimeve

⁷⁶ Shih *Balkan Insight*, BIRN, 12 korrik 2008, <http://balkaninsight.com/en/main/news/10967>.

⁷⁷ Citat në *Southeast European Times*, 10 nëntor 2008, www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2008/11/10/feature-01.

⁷⁸ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë ndërkombëtarë, Shkup, tetor 2008.

⁷⁹ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë ndërkombëtarë dhe zyrtarë qeveritarë, Shkup, tetor dhe nëntor 2008. Miratimi i qeverisë së njëzet ligjeve shtesë me procedurë emergjente në fillim të dhjetorit 2008, me shpjegimin se kërkohej nga ata që të mirreshin me krizën globale financiare, e bëri të dyshimtë vullnetin e saj për të plotësuar kriteret e BE-së. *Utrinski Vesnik*, 4 dhjetor 2008.

⁸⁰ *Utrinski Vesnik*, 4 nëntor 2008.

⁸¹ Për shembull, vendimi i presidentit, më 3 nëntor, për të përrjashtuar ndërmjetësuesin kryesor të Maqedonisë për çështjen e emrit, Nikola Dimitrov, rezultoi në një shkëmbim të ashpër ndërmjet Crvenkovskit dhe shefit të kabinetit të kryeministrit. *Utrinski Vesnik*, 7 dhe 10 nëntor 2008.

⁸² Përkundër nënvizimit të ngecjeve në mbledhje të kriterëve politike, kyçe për datën e hapjes së negociatave për anëtarësim, Rehn theksoi se Komisioni Evropian e konsideron çështjen e emrit si të veçantë, jashtë orbitës së partneritetit evropian të Maqedonisë. *Utrinski Vesnik*, 6 nëntor 2008.

⁸³ Pas theksimeve nga kryeministri se Maqedonisë do t’i mohohej data e fillimit të negociatave për anëtarësim në BE, për shkak të mosmarrëveshjes rreth emrit, përfaqësuesi special i BE-së i tha komisionit për Çështje Evropiane të Parlamentit Evropian se ishte gabim të minimizoheshin problemet e vendit. Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë maqedonas dhe ndërkombëtarë, Shkup, tetor 2008. “Fouere: Macedonia should take Responsibility for its Setbacks towards EU” [“Maqedonia duhet të marrë përgjegjësinë për ngecjet e saj drejt BE-së”], *Southeast European Times*, 14 shtator 2008, www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/neësbriefs/setimes/newsbriefs/2008/09/14/nb-05; and *Balkan Insight*, BIRN, 12 September 2008, <http://balkaninsight.com/en/main/neës/13098>.

të disa shteteve anëtare, të kryesuara nga presidenca sllovene, në futjen e një deklarate në Përfundime, që ishte esenciale.⁸⁴ U raportua se Ministria e Jashtme Dora Bakoyannis kishte refuzuar që të pajtohej me çfarëdo teksti që e linte të hapur mundësinë për të filluar bisedimet për anëtarësim në vitin 2008. Disa anëtarë të BE-së pohuan naivisht se teksti i futur nuk ishte asgjë më tepër sesa një refren për marrëdhënie të mira fqinjësie.⁸⁵

Kushtëzimi i ri u përsërit më 8 dhjetor nga ministrat e jashtëm të BE-së, të cilët deklaruan se ishte esenciale për Maqedoninë që “të ruajë marrëdhënie të mira fqinjësie, duke përfshirë edhe zgjidhjen e çështjes së emrit, të pranuar për të dy palët”.⁸⁶ Ministri i jashtëm francez ishte i drejtpërdrejtë: “Pa zgjidhjen e çështjes së emrit, ne nuk mund të ecim përpara, sepse kjo çështje duhet të zgjidhet së pari”.⁸⁷ Shtetet anëtare të BE-së gjithashtu shënuan se “hapat apo deklaratat që mund të ndikojnë negativisht në marrëdhëniet fqinjësore, duhet të shmangen”.⁸⁸ Kështu Athina e bëri zgjidhjen e çështjes së emrit si kusht shtesë për bisedimet për anëtarësim. Duke prezantuar referencën për “marrëdhënie të mira fqinjësore”, ajo e përvetësoi një kërkesë kyçe për Procesin e Stabilizim Asociimit të BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor, duke e vënë në shërbim të mosmarrëveshjes së saj bilaterale me Shkupin. Kështu që edhe nëse mosmarrëveshja rreth emrit nuk është faktori i vetëm që e mban mbrapa integrimin në BE, ajo do të duhet të adresohet në mënyrë që të mos bllokohet progresi.

Nëse Raporti i Progresit i Komisionit Evropian 2009 thotë se Maqedonia i ka plotësuar kriteret e parashtrura, me siguri se do të rekomandojë hapjen e negociatave për anëtarësim. Nëse Greqia i përmbahet qëndrimit të saj të tanishëm, dhe ndërkohë çështja e emrit nuk është zgjidhur, Këshilli Evropian me siguri se nuk do të vepronte sipas atij rekomandimi. Shtetet anëtare duket se nuk e kanë vullnetin që në mënyrë serioze t'i

⁸⁴ Këshilli Evropian shënoi se: “Mbajtja e marrëdhënieve të mira fqinjësore, përfshirë një zgjidhje të negociuar dhe të pranueshme për të dyja palët mbi çështjen e emrit, mbetet esenciale”. 19/20 qershor 2008, në www.eu2008.si/en/News_and_Documents/Council_Conclusions/June/0619_EC-CON.pdf.

⁸⁵ “Greeks Win Points on Macedonia at EU Summit” [“Grekët fitojnë poena rreth Maqedonisë në Samitin e BE-së”], *Balkan Insight*, BIRN, <http://balkaninsight.com/en/main/analysis/11299>.

⁸⁶ “Western Balkans Conclusion” [“Përfundimet për Ballkanin Perëndimor”], General Affairs and External Relations Council (GAERC), 8-9 dhjetor 2008.

⁸⁷ “France Warns Macedonia over ‘name row’” [“Franca e paralajmëron Maqedoninë rreth ‘përleshjes për emrin’”], *Balkan Insight*, BIRN, 8 dhjetor 2008. www.balkaninsight.com/en/main/news/15377/.

⁸⁸ GAERC.

bëjnë presion Greqisë që të zbusë qëndrimin e saj, dhe që të paktën të mundësojë fillimin e negociatave. Mirëpo për të ardhmen afat-mesme, Komisioni Evropian mund të vijojë vlerësimin e progresit nëpërmjet raporteve vjetore dhe të punojë me anë të nënkomisioneve të themeluara nën Marrëveshjen për Stabilizim Asociim të Maqedonisë, për të adresuar kërkesat teknike të procesit të anëtarësimit. Për aq gjatë sa Shkupi të lëvizë në këtë vijë, ajo do të mund të plotësojë shumicën e kërkesave për anëtarësim, madje edhe para hapjes formale të negociatave.⁸⁹

IV. ECJA PËRPARA

Për momentin, përpjekjet për të zgjidhur mosmarrëveshjen afatgjatë rreth emrit të Maqedonisë duket se kanë arritur në një pozitë të ngrirë. Edhe pse në vitin 2008 pati lëvizje nga ana maqedonase në gatishmërinë e tyre për të pranuar një emër kompleks dhe gjeografikisht të kualifikuar, Greqia ka ngulur këmbë dhe nuk duket e gatshme që të bëjë një gjest të njëjtë me koncesionet e veta, për të mundësuar një kompromis të arsyeshëm. Sidoqoftë, të dy palët e ndajnë përgjegjësinë për përkeqësimin e marrëdhënieve bilaterale të cilat tani janë më helmuese se në çfarëdo kohe që nga fillimi i viteve 1990-ta. Pas vendimit të Shkupit në nëntor 2008 për të dërguar Greqinë në GjND, mundësitë për progres të menjëhershëm duken të varfëra.

E megjithatë, mbetet rëndësia e gjetjes së një zgjidhjeje. Vendimi i Greqisë për të bllokuar anëtarësimin e Maqedonisë në NATO dhe progresi i mëtejshëm në integrimin në BE, e dëmtojnë një strategji të tërë për të dy organizatat për stabilizim të Ballkanit perëndimor nëpërmjet zgjerimit. Marrëveshja e Ohrit mbetet e brishtë, me tensione ndërmjet maqedonasve etnikë dhe shqiptarëve, dhe një ambient i paqetësuar rajonal, sidomos sa i përket Kosovës. As NATO-ja e as BE-ja nuk kanë mundësi që ta trajtojnë këtë vetëm si çështje thjesht bilaterale që mund të vazhdojë e pazgjidhur pafundësisht, me pasoja potencialisht serioze. Përpjekjet për të shtyrë të dy palët drejt një marrëveshjeje do të duhet të përfshijnë një gatishmëri më të madhe në mesin e shteteve anëtare të NATO-s dhe BE-së, për të bërë presion te Athina për të përvetësuar një qëndrim më konstruktiv, dhe për t'u përgjigjur koncesioneve nga Shkupi me koncesione të veta dhe të kuptimita.

Si prelude për t'u marrë me këtë çështje, të dyja palët duhet të marrin masa për rindërtimin e be-

⁸⁹ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të BE-së, Shkup dhe Bruksel, tetor dhe dhjetor 2008.

simit. Qeveria maqedonase duhet të mos bëjë hapa që janë të kalkuluar për të provokuar Athinën, para së gjithash të mos ofendojë ndjeshmëritë greke mbi trashëgiminë helenike, dhe të kthejë mbrapa ato vendime që tashmë kanë bërë fyerje, veçanërisht emrin e Aeroportit të Shkupit. Po ashtu, Shkupi dhe Athina duhet të marrin përsipër trajtimin e historisë së përbashkët të rajonit, nga kohërat antike e deri te ato moderne, në mënyrë që të arrijnë një kuptim të përbashkët dhe t'u shmangen referencave në literaturat shkollore që fyejnë ndjeshmëritë kombëtare të cilitdo vend. Kjo mund të arrihet nëpërmjet një komisioni të përbashkët të historianëve, diçka e ngjashme me atë që është bërë nga Gjermania dhe Franca pas Luftës së Dytë Botërore.

Të dyja vendet duhet të riafirmojnë përkushtimin e tyre për Marrëveshjen e Përkohshme të vitit 1995. Deri në marrëveshjen mbi emrin, Shkupi duhet të zotohet që të përdorë vetëm emrin e përkohshëm "ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë" në forumet multilaterale, si ai i OKB-së. Në anën tjetër, Greqia duhet të respektojë përkushtimin e saj ndaj Marrëveshjes së Përkohshme dhe të hedhë poshtë kërcënimin për të përdorur veton kundër anëtarësimit të Maqedonisë në NATO dhe në negociata për anëtarësim në BE.

Pas rindërtimit të një pjese besimi, duhet të bëhen përpjekje serioze për të gjetur zgjidhje rreth emrit të Maqedonisë. Derisa këto mund të vijnë nën ndërmjetësimin e OKB-së, ato duhet të mbështeten nga një përkushtim dhe involvim shumë më i madh nga shtetet anëtare të NATO-s dhe BE-së. Herën e vetme kur u arrit një progres i konsiderueshëm drejt arritjes së Marrëveshjes së Përkohshme, kjo përpjekje ishte mbështetur nga një vullnet i gjerë ndërkombëtar, përfshirë edhe presionin drejt Athinës për të mos kërcënuar stabilitetin në vetë fqinjësinë e saj. Kjo nuk do të jetë e lehtë. Politika vendore greke i bën të vështira koncesionet rreth emrit. Por do të ishte gabim të mendohet se Greqia është gjithmonë këmbëngulëse sa i përket fqit të saj verior. Shtetet anëtare të BE-së dhe NATO-s kanë hapësirë negociuese të kufizuar, por kjo s'është thotë se Athina është e pandikuar nga arsyeja. Ka treguar fleksibilitet në të kaluarën, rreth Marrëveshjes së Përkohshme dhe në përgjigjen e saj ndaj propozimeve të Nimetz të vitit 2005. Propozimi i vitit 2008 i Nimetz shkon edhe më tutje drejt adre-

simit të brengave të tyre, dhe liderët grekë duhet të vërejnë një gatishmëri më të madhe të Shkupit për të shndërruar koncesionet në shanse.

Konfident pas samitit të Bukureshtit, Athina duket se po beson që mund të insistojë në kërkesat e saj maksimale, dhe që eventualisht Shkupi do të duhet të lëshojë pe në të tri pikat kryesore: emri i vendit, hapësira e përdorimit të tij, si dhe mbiemrat për nacionalitet dhe gjuhë. Pritjet e tilla nuk janë realiste: Shkupi nuk do të bëjë kompromise rreth identitetit nacional të maqedonasve, dhe nuk duhet të pritjet një gjë e tillë nga ta. Edhe pse ekzistojnë ndryshime në mes të partive qeveritare dhe opozitare, kompromisi rreth identitetit nacional është jashtë çdo diskutimi për maqedonasit. Duke pasur parasysh gatishmërinë e Shkupit për të bërë kompromis me emrin e vendit, Athina duhet të veprojë me përgjegjësi dhe të pranojë identitetin "maqedonas" të fqinjve të saj, duke pasur parasysh pranimin e Shkupit se përdorimi i termit "maqedonas" nuk nënkupton ekskluzivitet dhe nuk sfidon zbatimin e mbiemrit të njëjtë për banorët e provincës greke të Maqedonisë.

Në klimën e tanishme të mosbesimit, qeveria maqedonase nuk është e gatshme që të deklarojë publikisht për gatishmërinë e saj për kompromis rreth emrit, edhe pse në përgjithësi dihet se në Bukuresht kishte ofruar kompromis. Megjithatë, duhet që publikisht të shprehë gatishmërinë e saj për të pranuar propozimin e fundit të Nimetz për emrin, si sfidë Athinës që ajo të bëjë një gjest të ngjashëm sa i përket identitetit nacional, dhe shteteve të tjera anëtare të BE-së dhe NATO-s për të bërë presion për kompromis grek. Hezitimi i Shkupit për të hequr dorë nga sukcesi që kishte pasur me njohjen e emrit të saj kushtetues nga më shumë se gjysma e vendeve anëtare të OKB-së është i kuptueshëm, por nuk duhet të pengojë marrëveshjen. Në realitet, me arrijtjen e një marrëveshjeje rreth emrit për përdorim multilateral, gati të gjitha shtetet anëtare të NATO-s dhe BE-së do ta adaptonin atë po ashtu për përdorim bilateral. Fakti se një duzinë shtetesh, shumica larg nga Ballkani, e kanë njohur Maqedoninë me emrin e saj kushtetues, ka rëndësi të vogël praktike si për Maqedoninë ashtu edhe për Greqinë.

Prishtinë/Bruksel, 12 janar 2009

ANEKSI A

HARTA E MAQEDONISË DHE GREQISË



Kjo hartë është adaptuar nga Grupi Ndërkombëtar i Krizave, marrë nga Harta Nr. 3877 Rev. 7 (Shtator 2008) të Seksionit Kartografik të OKB-së. Hapsira e hijesuar paraqet përafërsisht Greqinë Maqedonase.